

Letërnjoftimi i Komunës së

KLINËS

2014

Maj, 2015



Fakte


- Më 2014, Komuna e Klinës kishte buxhet prej 8.1 milion eurove, një rritje prej afro 100 mijë eurosh në krahasim me vitin 2013.
- Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me dy vitet paraprake. Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë 29.42% të të hyrave të përgjithshme.
- Numri total i të punësuarve në administratë në komunën e Klinës është 151. Klina ka të punësuar një shërbyes civil për 262 banorë. Bazuar në mesataren në shkallë vendi , e cila është një shërbyes civil për 278 banorë, del se Klina ka më shumë të punësuar në krahasim me popullsinë që ka.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 647 persona, prej tyre 535 mësimdhënës. Në Komunën e Klinës raporti nxënës/mësimdhënës është 35.6. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 146 punonjës. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Klinës është 270.9. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.
- Klina gjatë vitit 2014 ka pasur 4328 persona që janë llogaritur nën skemën sociale. Krahasuar me numrin total të popullsisë në këtë komunë del se në Klinë rreth 11% e popullsisë të ardhurat i bazojnë në skemat sociale.
- Në Komunën e Klinës funksionojnë 902 biznese.
- Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 130 biznese të reja.
- Në të njëjtën periudhë, janë shuar 10 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e industrisë përpunuese.
- Kryetari i Klinës z. Sokol Bashota gjatë fushatës zgjedhore ka dhënë 23 premtime nga fushat e ndryshme. Deri në maj 2015, shkalla e realizueshmërisë së premtimeve është 13%, mesatarja në shkallë vendi është 24%.

2 Qeverisja komunale

Edhe në zgjedhjet e fundit lokale (2013) qytetarët e komunës së Klinës ia besuan votën dhe i vazhduan mandatin për të tretën herë z. Sokol Bashota nga radhët e PDK-së.


Në raundin e parë në zgjedhje kanë votuar 19,051 apo rreth 44% qytetarë me të drejtë vote. Në balotazhin e mbajtur me 1 dhjetor 2013, Sokol Bashota ka marr 75.12%, ndërsa Enver Berisha (AAK – LDD) ka rezultuar me 24.88%.

Grafikoni nr.1 Dallimi mes votave



Zgjedhjet për Kuvendi Komunal kanë nxjerr këtë përbërje: PDK 9 ulëse, LDK 5 ulëse, AAK-LDD 5 ulëse, Iniciativa Qytetare Klinë dhe Iniciativa për Progresin e Klinës me nga 2 ulëse, PSHDK, LVV, AKR dhe G.I. Srpska me nga 1 ulëse.


Grafikoni nr.2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Klinës në bazë të zgjedhjeve 2013



3 Buxheti i Komunës së Klinës


Më 2014, Komuna e Klinës kishte buxhet prej 8.1 milion eurove, një rritje prej afro 100 mijë eurosh në krahasim me vitin 2013. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shpenzohet për paga dhe mëditje për 944 të punësuarit në arsim, shëndetësi dhe administratë. Buxheti për investime kapitale është 2.2 milion euro, një rënie e lehtë në krahasim vitin paraprak.

Grafikoni nr. 3 Buxheti total i Komunës së Klinës dhe kategoritë kryesore buxhetore




Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Klinës ishin 916 mijë euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me dy vitet paraprake.

Grafikoni nr.4 Trendi i të hyrave vetanake të Komunës së Klinës 2011-2015




Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë 29.42% të të hyrave të përgjithshme.

Grafikoni nr.5 Kategoritë e të hyrave buxhetore




Në krahasim me komunitet tjera të cilat kanë numër të përafërt të popullsisë dhe territorit, Komuna e Klinës ka arritur të mbledh më shumë të hyra nga tatimi në pronë se sa komuna si Malisheva, Kamenica, Kaçaniku etj., ndërsa më pak se sa Istogu, Rahoveci, Obiliqi etj.

Grafikoni nr.6 Krahasimi i komunave për nga të hyrat nga tatimi në pronë



Shpenzime për telefona fiks, udhëtime jashtë vendit, riparim të veturave kanë shënuar rënie në krahasim me një vit më parë, ndërsa kategoria për telefoni mobile, për mëditje jashtë vendit dhe shpenzimet për dreka zyrtare kanë shënuar rritje, ashtu siç mund të shihet nga figura 7.


Grafikoni nr. 7 Shpenzimet për disa kategori buxhetore



Instituti GAP

Komuna e Klinës gjatë vitit 2014 për rrymë elektrike ka shpenzuar 82,214 euro, apo 3,215 euro më shumë se sa viti paraprak.


Grafikoni nr. 8 Shpenzimet komunale sipas kategorive dhe viteve



4 Të punësuarit në sektorin publik


Vitin 2014 Klina e ka përmbyllur me 944 të punësuar në sektorin publik, 6 punonjës më shumë se në vitin e kaluar. Vetëm në administratë komunale janë të punësuar 151 punonjës.

Grafikoni nr.9 Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Klinës




Klina ka të punësuar një shërbyes civil për 262 banorë. Bazuar në mesataren në shkallë vendi , e cila është një shërbyes civil për 278 banorë, del se Klina ka më shumë të punësuar në krahasim me popullsinë që ka.

Grafikoni nr.10 Raporti të punësuar në administratë për kokë banori




Në sektorin e arsimit janë të punësuar 647 persona, prej tyre 535 mësimdhënës. Në Komunën e Klinës raporti nxënës/mësimdhënës është 35.6. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.

Grafikoni nr.12 Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Klinës



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 146 punonjës. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Klinës është 270.9. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.


Grafikoni nr.13 Punonjës shëndetësor për kokë banori



5 Ekonomia lokale

Numri i bizneseve aktive të regjistruara në komunën e Klinës është 902, prej të cilave 47 kanë veprimtari prodhuese. Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 130 biznese të reja, një numër më i vogël se ai i vitit paraprak. Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara më 2014 janë biznese me fushë veprimtari bujqësore.


Grafikoni nr.14 Llojet e bizneseve të reja të regjistruara më 2014



Instituti GAP

Por, në të njëjtën periudhë, janë shuar 10 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e industrisë përpunuese.

Grafikoni nr.15 Llojet e bizneseve të shuara më 2014



6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Sokol Bashota gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 23 premtimet e monitoruara, del se deri në maj 2015 z. Bashota ka arritur të realizoj 13% te premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

Grafikoni nr.16 Premtimet e Kryetari dhe shkalla e realizimit





Instituti GAP

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2
+381 38 609 339

info@institutigap.org
www.institutigap.org
www.komunat.institutigap.org

